

KE-ja pret heqjen
e plotë të masave ndaj
Kosovës në javët e
ardhshme



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKIMI I ISH-KRERËVE TË UÇK-SË: DEKLARATAT PËRMBYLLËSE
NË MUAJIN SHKURT

FAQE 4-5

PDK-ja: GJYKIMI NË HAGË TË PËRMBYLLET ME DREJTËSI DHE LIRI PËR ÇLIRIMTARËT



Pas njoftimit të Gjykatës Speciale se nga 9 deri më 18 shkurt do të zhvillohen deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, të cilët ndodhen në paraburgim në Hagë që mbi pesë vjet, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka theksuar të premtën edhe një herë nevojën që ky proces, i shoqëruar me problematika serioze, të përmbyllet me drejtësi. "Në këtë fazë përmbyllëse është thelbësore që gjykimi të përqendrohet ekskluzivisht te drejtësia e paanshme, te faktet dhe te provat, duke u larguar nga çdo qasje politike, interpretuese apo spekulative që e ka shoqëruar këtë proces gjatë këtyre pesë viteve", ka theksuar PDK-ja në një deklaratë për medie

NGA PO
SHKON
LDK-ja?

F. 3



RREGULLA TË REJA
PËR AUTOMJETET
ME TARGA TË
HUAJA, ZBATIMI
NGA 15 MARS

F. 5



OPINION

PËRRALLAT PËR PRESIDENTIN F. 6

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



TRUMPI E PRANON MEDALJEN
E NOBELIT NGA UDHËHEQËSJA
E OPOZITËS VENEZUELASE,
MACHADO F. 2

ZKA-JA FILLON AUDITIMIN PËR
SIGURINË E NXËNËSVE NË
SHKOLLAT PUBLIKE NË KOSOVË F. 3

EKONOMI



KOSOVA NË PRITJE
TË BUXHETIT, EKSPERTËT
PARALAJMËROJNË KOLAPS F. 8

259 MILIONË EURO IMPORTI I
RRYMËS NË VITIN 2025, YMERI
NGRE DYSHIME PËR NOA-n DHE
VUK HAMOVIQIN F. 8

SPORT

KUKA: TË NDËRTOSH KAMPIONË
NGA KOSOVA ËSHTË SI TA NDËRTOSH
NJË 'FERRARI' F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Buniamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI E PRANON MEDALJEN E NOBELIT NGA UDHËHEQËSJA E OPOZITËS VENEZUELASE, MACHADO

UASHINGTON, 16 JANAR - Udhëheqësja e opozitës venezuelase, Maria Corina Machado, ia dhuroi medaljen e saj të Çmimit Nobel për Paqe presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, të enjten gjatë një takimi në Shtëpinë e Bardhë. Një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë konfirmoi se Trumpi synon ta mbajë medaljen. Në një postim në rrjetet sociale të enjten në mbrëmje, Trumpi shkroi: “Maria ma dha Çmimin e saj Nobel për Paqe për punën që kam bërë. Ky është gjest i mrekullueshëm i respektit të ndërsjellë. Faleminderit Maria!” Machado, e cila e përshkroi takimin me Trumpin “të shkëlqyer”, tha se ia bëri atij këtë dhuratë për ta njohur angazhimin e tij për lirinë e popullit venezuelas. Shtëpia e Bardhë publikoi më

vonë një fotografi të Trumpit dhe Machadon, ku presidenti shihet duke mbajtur një kornizë të madhe me ngjyrë ari që shfaq medaljen. “Presidentit Donald J. Trump, në shenjë mirënjohjeje për udhëheqjen tuaj të jashtëzakonshme në promovimin e paqes përmes forcës. Simbol personal mirënjohjeje në emër të popullit venezuelas”, shkruhej në të. Machado ka bërë përpjekje për të ndikuar te Trumpi, pasi ai kishte hedhur poshtë mundësinë që ajo ta zëvendësonte Nicolas Maduron e rrëzuar si udhëheqëse e Venezuelës. Megjithëse Machado ia dha Trumpit medaljen e artë që marrin fituesit e çmimit, çmimi mbetet i saj, pasi Instituti Norvegjez Nobel ka thënë se çmimi nuk mund të transferohet, ndahet apo revokohet.



I pyetur të mërkurën nëse donte që Machado t’ia jepte atij çmimin, Trumpi i tha Reutersit: “Jo, nuk e thashë këtë. Ajo e fitoi Çmimin Nobel për Paqe”. Presidenti republikan ka shprehur prej kohësh interesim për ta fituar këtë çmim dhe herë pas here e ka lidhur atë me arritjet e tij diplomatike.

Takimi i së enjtes, që duket se zgjati pak më shumë se një orë, ishte i pari mes Trumpit dhe Machados. Më pas Machado u takua me më shumë se një duzinë senatorësh, republikanë dhe demokratë, në Kongres ku përgjithësisht ka gjetur aleatë më entuziastë. Gjatë vizitës zëdhënësja e

Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt, tha se Trumpi kishte pritur me padurim takimin me Machadon, por qëndron pas vlerësimit të tij “realist” se ajo aktualisht nuk e ka mbështetjen e nevojshme për ta udhëhequr vendin në afat të shkurtër. Machado, e cila u largua nga vendi i Amerikës së Jugut në dhjetor përmes një arratisjeje të guximshme detare, po garon kundër anëtarëve të Qeverisë së Venezuelës për vëmendjen e Trumpit dhe po kërkon të sigurojë një rol në qeverisjen e vendit në të ardhmen. Pasi Shtetet e Bashkuara e kapën Maduron këtë muaj në një operacion të shpejtë, figura të opozitës, anëtarë të diasporës venezuelase dhe politikanë në të gjithë ShBA-në dhe Amerikën Latine shprehën shpresën që Venezuela të nisë një proces demokratizimi.

A DO TË MARRË FUND LUFTA GATI KATËRVJEÇARE? ZELENSKY: MARRËVESHJA ME SHBA-NË MUND TË NËNSHKRUHET JAVËN E ARDHSHME

KIEV, 16 JANAR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka deklaruar se dokumentet për një marrëveshje në mes të Ukrainës dhe Shteteve të Bashkuara mund të nënshkruhen që javën e ardhshme nëse palët arrijnë pajtimin përfundimtar brenda kësaj periudhe. Zelensky tha se marrëveshja mund të miratohet në Davos të

Zvicrës, ku pritet të mblidhen liderë ndërkombëtarë në kuadër të Forumit Ekonomik Botëror, mes tyre edhe Donald Trump. Sipas tij, një delegacion ukrainas do të udhëtojë drejt ShBA-së për bisedime që lidhen me garancitë e sigurisë dhe një paketë prosperiteti për Ukrainën. Kievi synon të marrë qartësi nga Uashingtoni mbi qëndrimin e Rusisë në raport me negociatat.

Presidenti ukrainas theksoi se vendi i tij ka nevojë për garanci sigurie afatgjatë, që mos të varet nga mandati i një presidenti të vetëm amerikan. Zelensky e akuzoi Rusinë për pengimin e përpjekjeve për paqe, duke shtuar se ultimatumet nuk janë mënyrë për të zhvilluar diplomaci dhe për të arritur një zgjidhje reale të konfliktit.



ITALIA REFUZON DËRGIMIN E TRUPAVE NË GROENLANDË, ROMA ZGJEDH RRUGËN POLITIKE DHE KOORDINIMIN ME NATO-n

ROMË, 16 JANAR - Italia nuk do të marrë pjesë në operacionin ushtarak “Arctic Endurance” në Groenlandë, të propozuar nga Danimarka dhe i mbështetur nga disa vende evropiane si përgjigje ndaj ambicieve amerikane të ish-presidentit Donald Trump. Vendimi është konfirmuar në mënyrë të qartë nga qeveria italiane, me mbështetjen e kryeministres Giorgia Meloni, e cila aktualisht ndodhet në Japoni. Ministri i Mbrojtjes, Guido Crosetto, gjatë një deklarate në Senat, ironizoi idenë e një pranie të shpërndarë ushtarake në Arktik: “Çfarë po bëjnë njëqind, dyqind apo treqind ushtarë të çdo kombësie në Groenlandë? Tingëllon si fillimi i një shakaje.

Nuk është një garë për të dërguar ushtarë nëpër botë. Qasja jonë është racionale. Ne i kemi kërkuar NATO-s të koordinohet. Duhet të bashkohemi, jo të përçahemi.” Qëndrimi i Romës u përforcua edhe nga një takim rreth një orë e gjysmë i zhvilluar në Farnesina, mes ministrit të Jashtëm Antonio Tajani dhe ambasadorëve italianë në Danimarkë, NATO dhe Bruksel. Nga çdo këndvështrim, mesazhi mbetet i pandryshuar: asnjë trupë italiane në Groenlandë. Për Ministrinë e Jashtme italiane, iniciativa e Trumpit përfaqëson ende “një kërcënim” dhe ekziston ndërgjegjësimi se Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë përpara me



qëndrimin e tyre. Megjithatë, Italia këmbëngul se zgjidhja duhet të jetë politike, në një përpjekje të vështirë balancimi mes Evropës, NATO-s dhe ShBA-ve, të cilat mbeten partneri kryesor i Aleancës Atlantike. Këto ditë pritet të paraqitet dokumenti strategjik mbi angazhimin e Italisë në Arktik. Parashikohet edhe një

videomesazh nga kryeministrja Meloni, e cila do ta theksojë “rëndësinë strategjike” të rajonit. Sipas dokumentit 52-faqesh të shqyrtuar nga “Corriere della Sera”, Italia, ndonëse nuk është një shtet arktik, e konsideron stabilitetin e rajonit si thelbësor për sigurinë evropiane dhe euroatlantike. Strategjia italiane parashikon kontribut joushtarak, përfshirë ekspertizë në sigurinë kibernetike, mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe bashkëpunim në sistemet satelitore për mbikëqyrje detare, monitorim mjedisor dhe kontroll të rrugëve detare në Arktik. Dokumenti nënvizon mbështetjen për sovranitetin e

Groenlandës dhe Danimarkës, por edhe shqetësimin për praninë dhe manovrat ruse dhe kineze në rajon. Në këtë kuadër, Italia mbështet “një përgjigje të fortë, por të përgjegjshme euroatlantike”, të bazuar në parandalim, bashkëpunim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Në një kontekst të ndërlikuar diplomatik, kryeministrja Meloni përballlet me një agjendë të ngjeshur ndërkombëtare: nga pjesëmarrja e pritshme në nisma të reja diplomatike të promovuara nga Trumpi, deri te samiti ndërqeveritar Itali - Gjermani në Romë më 23 janar, me kancelarin Friedrich Merz, i cili është shprehur i gatshëm për dërgimin e trupave në Groenlandë.

NGA PO SHKON LDK-ja?

Pas rezultatit të dytë më të dobët zgjedhor që nga paslufta dhe përplasjeve të hapura në udhëheqje, Lidhja Demokratike e Kosovës po përballlet me pyetje të mëdha për të ardhmen e saj politike. Heshtja e disa figurave kyçe, dorëheqjet, dilemat për reformë dhe raporti me pushtetin e ri, po e vendosin partinë më të vjetër në Kosovë në një udhëkryq vendimtar

PRISHTINË, 16 JANAR - Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit të vitit të kaluar sollën rezultatin e dytë më të keq për Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), partinë më të vjetër në Kosovë që nga paslufta. Por, përballë këtij momenti vendimtar për të ardhmen e partisë, Radios Evropa e Lirë (REL) s'i folën shumë nga përfaqësuesit e LDK-së, si: Lumir Abdixhiku, Lutfi Haziri, Hykmete Bajrami, Jehona Lushaku Sadriu, Avdullah Hoti, Anton Quni, Doarsa Kica Xhelili, Besian Mustafa, Arben Gashi e Agim Veliu.

Për politologun Dritëro Arifi kjo simbolizon “mbylljen” e LDK-së që kur u morën vesh rezultatet e zgjedhjeve, se ajo mori vetëm 13 23 për qind të votave. Arifi shpreson që, të paktën, kjo kohë po shfrytëzohet për të menduar për “risitë që duhet të sjellë LDK-ja në strukturat e partisë”. Për njohësen e zhvillimeve politike, Donika Emini, risia kryesore që i duhet LDK-së është ikja nga një lloj “gjumi letargjik”. “Prej 2021 deri më 2025, partia nuk ka qenë aktive në mënyrë të qëndrueshme, dhe kjo ka pasur pasoja të dukshme në perceptimin e saj si forcë politike”, thotë Emini për REL-in.

Por, mbrëmjen e së mërkurës u shpërfaqën në “Facebook” disa mosmarrëveshje nga debati i brendshëm në LDK. Nënkryetarja e partisë, Hykmete Bajrami, tha se ka dhënë dorëheqje nga pozita e saj, dhe kërkoi që të njëjtën ta bënte edhe kryetari Abdixhiku.

Ky i fundit, duke kërkuar që të tjerët “të sillen pa dramë e pa protagonizëm”, përsëriti se e ka ofruar dorëheqjen, por se vendimin për pranimin ose jo të saj do ta marrë Kuvendi i partisë.

LDK-ja përballë dy testeve të para

Një test i parë për të ardhmen e LDK-së pritet të jetë reformimi ose jo i udhëheqjes së saj. “Derisa e kemi një kryetar, që thotë: ‘Unë po shkoj; por, nëse



ju më besoni, unë mund të vazhdoj’... Kjo tregon që këtu nuk ka qasje [për të ardhmen e partisë]. Këtu ka më shumë interesa personale sesa partiake”, thotë Arifi për REL-in. Një tjetër moment kyç që mund ta formësojë LDK-në është edhe bashkëpunimi ose jo me partinë fituese të zgjedhjeve, Lëvizjen Vetëvendosje (LV), për mandatin e ri pesëvjeçar të presidentit, që duhet të zgjidhet më 4 mars. “Hapi më i mençur për LDK-në do të ishte ta pranonte rezultatin e zgjedhjeve dhe të mos e bllokonte procesin e zgjedhjes së presidentit”, thotë Emini.

Ajo beson se nëse LDK-ja nuk tregohet bashkëpunuese, asaj mund t'i largohen deputetë drejt LV-së, ose të pësojë rënie edhe më të madhe në zgjedhjet e ardhshme.

Ku gaboi LDK-ja dhe si mund ta rikthejë besimin e elektoratit?

Rezultatet e veta më të mira LDK-ja i gëzoi në vitet e para të pasluftës nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës. Atëbotë kjo parti fitonte rreth 45 për qind, por tani ka rënë në rreth 13 për qind. Për Arifin sinjale për rënien e LDK-së ka pasur mjaft. “Këto janë gjëra që partitë nuk duan t'i pranojnë, jo që nuk i dinë”, thotë ai, duke shtuar se rënia e tillë tregon se ka dështuar e gjitha struktura e LDK-së në nivel vendi.

Një nga arsytet pse LDK-ja ka humbur besimin e shumë qytetarëve, thotë Arifi, është se ardhjet e fundit në parti e kanë përmirësuar listën për deputetë, por s'kanë sjellë shumë vota, pasi

nuk janë integruar në udhëheqje të partisë.

Për Eminin, gabimi i LDK-së qëndron te “ngjirja në kohë” dhe insistimi në “frymën rugoviane”, ndërkohë që “votuesit kërkojnë zgjidhje të reja dhe përfaqësim të generatave të reja”.

Por, ajo thekson edhe disa përçarje brenda partisë. “Heqja e Agim Velikut nga lista ishte e kushtueshme politikisht. Veliu përfaqësonte një pjesë më tradicionale të LDK-së, dhe mungesa e tij ndikoi në rezultatin e partisë”, thotë Emini, duke shtuar se, në anën tjetër, njerëzit e rinj s'tërhoqën votat e të rinjve që kërkonin ide të reja.

Ajo shton se me sfida të ngjashme përballlet edhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Si dy partitë kryesore në vitet e para të pasluftës dhe pas pavarësisë së Kosovës, tani këto dy parti po e

kanë të vështirë të shfaqen si alternative serioze qeverisëse ndaj LV-së.

E si mund të ndryshojë kjo? Duke u reformuar, thotë Emini.

Si hap i parë, shton ajo, është pranimi i realitetit: LDK-ja radhitet si partia e tretë më e madhe në vend, me vetëm 15 vende të fituara në Kuvend nga gjithsej 120.

Hapat e radhës i theksojnë po aq fuqishëm edhe Emini, edhe Arifi: LDK-ja duhet të bëjë matje e analiza se pse ka humbur, e pastaj të pozicionohet si opozitë sa aktive, po aq edhe konstruktive.

Duke qenë aktive në Kuvend, në raport me mediet, me shoqërinë civile, me pozitën e opozitën, Emini thotë se LDK-ja mund të paraqitet si forcë e madhe politike edhe me numër të vogël deputetësh.

ZKA-ja fillon auditimin për sigurinë e nxënësve në shkollat publike në Kosovë



PRISHTINË, 16 JANAR - Në kuadër të zbatimit të Planit Vjetor të Auditimit 2025/2026, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka filluar auditimin e performancës me temën “Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë” nga klasa VI-XII për periudhën 2022-2025.

Auditimi synon të vlerësojë nëse shkollat publike në

Kosovë ofrojnë ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për nxënësit si dhe nëse institucionet përgjegjëse kanë vendosur dhe zbatojnë mekanizma efektivë për parandalimin, trajtimin, raportimin dhe monitorimin e incidenteve të dhunës në shkolla.

Fushëveprim i këtij auditimi do të përfshijë Ministrinë e

Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit, Inspektoratin e Arsimit si dhe Drejtoritë e Arsimit në komunat e Prishtinës, Ferizajt dhe Gjakovës. Gjithashtu, në fushëveprim mund të përfshihen edhe Policia e Kosovës dhe drejtoritë e saj rajonale, si dhe Qendrat për Punë Sociale të tri komunave që i nënshtrohen këtij auditimi.



GJYKIMI I ISH-KRERËVE TË UÇK-SË: DEKLARATAT PËRMBYLLËSE NË MUAJIN SHKURT

PDK-JA: GJYKIMI NË HAGË TË PËRMBYLLET ME DREJTËSI DHE LIRI PËR ÇLIRIMTARËT

Pas njoftimit të Gjykatës Speciale se nga 9 deri më 18 shkurt do të zhvillohen deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, të cilët ndodhen në paraburgim në Hagë që mbi pesë vjet, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka theksuar të premtën edhe një herë nevojën që ky proces, i shoqëruar me problematika serioze, të përmbyllet me drejtësi. “Në këtë fazë përmbyllëse është thelbësore që gjykimi të përqendrohet ekskluzivisht te drejtësia e paanshme, te faktet dhe te provat, duke u larguar nga çdo qasje politike, interpretuese apo spekulative që e ka shoqëruar këtë proces gjatë këtyre pesë viteve”, ka theksuar PDK-ja në një deklaratë për medie

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 JANAR - Deklaratat përmbyllëse në çështjen kundër ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do të mbahen nga 9 deri më 18 shkurt, njoftuan Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë. Ish-eprrorët e UÇK-së Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të katërtit janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që rëndojnë ndaj tyre. Sipas njoftimit, parashihet që fillimisht Zyra e Prokurorit të Specializuar ta mbajë deklaratën përmbyllëse më 9 shkurt. Një ditë më pas, radha do të jetë e mbrojtësit të viktimave. Më 11 shkurt deklaratën përmbyllëse është paraparë ta

bëjë ekipi mbrojtës i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Më 12 shkurt do ta ketë radhën mbrojtja e ish-kryeparlamentarit Kadri Veseli, ndërsa një ditë më pas ajo e ish-deputetit Rexhep Selimi dhe ish-kryeparlamentarit Jakup Krasniqi. Më 16 shkurt parashihet të vazhdojë deklarata përmbyllëse e ekipit mbrojtës të Krasniqit dhe më pas është paraparë kohë për pyetje të mundshme të trupit gjykues. Dy ditë më vonë, më 18 shkurt, sipas rendit të ditës që Dhomat e Specializuara thanë se mund të ndryshojë, do të ketë përgjigje për palët dhe deklaratat e të akuzuarve. Para deklaratave përmbyllëse, palët do t'i dorëzojnë dosjet përfundimtare deri më 30 janar. Pas kësaj, trupi gjykues ka tre muaj kohë që të marrë një vendim dhe ta shpallë atë. Siç kanë thënë më

herët nga Gjykata në Hagë, trupi gjykues mund ta kërkojë zgjatjen e afatit për marrjen e një vendimi edhe për dy muaj të tjerë dhe, në raste të jashtëzakonshme, edhe më gjatë. Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020. Gjykimi ndaj tyre nisi në prill të vitit 2023. Fillimisht, Zyra e Prokurorit të Specializuar thirri në gjykatore 125 dëshmitarë, ndërsa 117 të tjerë dorëzuan dëshmitë e tyre me shkrim. Në shtator të këtij viti mbrojtja e Thaçit dhe Krasniqit paraqitën dëshmitarë, ndërsa Veseli dhe Selimi nuk paraqitën prova mbrojtëse. Në mesin e dëshmitarëve të mbrojtjes së Thaçit që u paraqitën në Hagë ishin kryesisht zyrtarë të lartë perëndimorë me njohuri të drejtpërdrejtë të ngjarjeve. Aty u përfshin ish-ndihmësekretari

amerikan i Shtetit, James Rubin, dhe gjenerali amerikan në pension, Wesley Clark, i cili udhëhoqi fushatën ajrore të NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe më 1999. Ndërsa Thaçi po përballët edhe një rast tjetër për pengim të drejtësisë dhe gjykimi për këtë çështje është caktuar të nisë më 24 shkurt të këtij viti.

Pas njoftimit të Gjykatës Speciale për deklaratat përmbyllëse, PDK-ja thotë se ky proces është karakterizuar me zvarritje të panevojshme

Pas njoftimit të Gjykatës Speciale se nga 9 deri më 18 shkurt do të zhvillohen deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, të cilët ndodhen në paraburgim në Hagë që mbi pesë vjet, Partia Demokratike e Kosovës thekson edhe një herë nevojën që ky proces, i shoqëruar me problematika serioze, të përmbyllet me drejtësi. PDK-ja ka theksuar se ky proces është karakterizuar me zvarritje të panevojshme, paqartësi procedurale dhe vendime që kanë ngritur shqetësime të vazhdueshme mbi standardet e drejtësisë dhe respektimin e të

drejtave themelore të njeriut. “Këto rrethana kanë cenuar perceptimin e drejtësisë së barabartë dhe kanë rënduar padrejtësisht mbi çlirimtarët dhe ish-udhëheqësit e shtetit tonë, të cilët tashmë kanë kaluar një periudhë të gjatë në paraburgim. Në këtë fazë përmbyllëse është thelbësore që gjykimi të përqendrohet ekskluzivisht te drejtësia e paanshme, te faktet dhe te provat, duke u larguar nga çdo qasje politike, interpretuese apo spekulative që e ka shoqëruar këtë proces gjatë këtyre pesë viteve”, ka theksuar PDK-ja në një deklaratë për medie. PDK-ja ka thënë se dëshmitarët kyçë në këtë proces gjyqësor kanë hedhur poshtë në mënyrë të qartë pretendimet kryesore të aktakuzës, duke rrëzuar çdo dyshim mbi fajësi individuale, grupe apo komanduese. “Këto dëshmi kanë kontribuar ndjeshëm në sqarimin e rrethanave faktike dhe kanë rrëzuar bazën e akuzave të prokurorisë. Partia Demokratike e Kosovës mbetet e përkushtuar ndaj sundimit të ligjit, paqes dhe drejtësisë, duke besuar se vetëm një vendim i drejtë dhe profesional mund të kontribuojë në mbylljen e këtij kapitulli të rëndësishëm për Kosovën, drejtësinë ndërkombëtare dhe të ardhmen e rajonit tonë”, është thënë në deklaratën e PDK-së.

RREGULLA TË REJA PËR AUTOMJETET ME TARGA TË HUAJA, ZBATIMI NGA 15 MARS

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 JANAR - Ministria e Punëve të Brendshme ka dhënë informata në lidhje me automjetet e regjistruara në vendin e huaj e që lëvizin në trafikun rrugor të Republikës së Kosovës, e që i pari rregull renditet që automjeti i regjistruar në vendin e huaj në pronësi të shtetasit të huaj, lejohet të qarkullojë deri tre muaj nga data e hyrjes në Kosovë.

Zbatimi i plotë i saj, sipas MPB-së, do të fillojë më 15 mars 2026 dhe mosrespektimi i pikave të mësipërme përbën shkelje të ligjeve që rregullojnë fushën e trafikut dhe do të merren masa në përputhje me legjislacionin përkatës. "Të dashur vizitorë, mirë se vini në Republikën e Kosovës! Ju urojmë qëndrim të këndshëm në vendin tonë. Jemi të detyruar t'ju informojmë për të drejtat dhe detyrimet tuaja në lidhje me Ligjin për Automjetet në Republikën e Kosovës, në mënyrë që qëndrimi juaj në vendin tonë të jetë

më i lehtë dhe në përputhje me rregullat dhe ligjet e vendit tonë. Automjeti i regjistruar në vendin e huaj në pronësi të shtetasit të huaj, lejohet të qarkullojë deri tre (3) muaj nga data e hyrjes në Kosovë; Automjeti i regjistruar në vendin e huaj në pronësi të qytetarit të Kosovës, lejohet të qarkullojë deri tre (3) muaj nga data e hyrjes në Kosovë. Qytetari i Kosovës duhet të ketë të rregulluar lejen e qëndrimit të përkohshme ose të përhershme dhe ta tregoj në çdo rast kur kërkohet nga personi i autorizuar; Automjetin e regjistruar jashtë Kosovës nuk mund ta drejtojë shtetasi kosovar pa praninë e pronarit dhe as të autorizohet që të qarkullojë në Kosovë; Automjeti i regjistruar në vendin e huaj në pronësi të qytetarit të Kosovës me qëndrimi të përkohshëm ose të përhershëm jashtë Kosovës mund ta drejtojë qytetari i Kosovës nëse i njëjti gjithashtu ka qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në shtetin prej nga vjen automjeti dhe duhet të ketë autorizim nga shteti ku është i regjistruar

automjeti; Personi i cili nuk ka të rregulluar qëndrimin e përkohshëm ose të përhershëm nga vendi ku importohet automjeti, lejohet të qarkullojë deri në tetë (ditë nga data e hyrjes në Kosovë; Shtetasi i huaj të cilit i është lejuar qëndrimi i përkohshëm ose i përhershëm në Kosovës apo qytetari i Kosovës i cili kthehet nga shtetet e huaja mund të drejtojë automjetin me patentë shofer të huaj të vlefshme deri në një (1) vit nga dita e hyrjes në Kosovë", ka njoftuar MPB-ja.

Sipas këtij njoftimi, zbatimi i plotë fillon më 15 mars 2026 dhe mosrespektimi i pikave të mësipërme përbën shkelje të ligjeve që rregullojnë fushën e trafikut dhe do të merren masa në përputhje me legjislacionin përkatës.

**Kurti bisedon me
ndërkombëtarët për zbatimin e ligjeve për automjetet dhe të huajt**

Me ftesë të tij, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, bashkë me

zëvendëskryeministrin në detyrë, Besnik Bislimi, ka mirëpritur të premten në takim ambasadorët, të ngarkuarit me punë, shefat e misioneve diplomatike dhe përfaqësues diplomatikë të akredituar në Kosovë.

Në kuadër të komunikimit të rregullt dhe zhvillimeve të fundit, kryeministri Kurti dhe zëvendëskryeministri Bislimi i njoftuan për fazat e zbatimit të Ligjit për të Huajt dhe Ligjit për Automjete, ligje këto të harmonizuara me legjislacionin e Bashkimit Evropian, dhe veprimet afirmative që institucionet e Republikës së Kosovës do të ndërmarrin për zbatimin e plotë të këtyre dy ligjeve.

Faza e parë e zbatimit, e cila nis sot, parasheh një periudhë informimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore. Vizitorët që hyjnë në vendkalimet kufitare do të pajisen me materiale informuese të cilat ofrojnë udhëzime të qarta mbi të drejtat, detyrimet dhe procedurat përkatëse që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi. Paralelisht do të organizohen sesione

informuese me qytetarë, fushatë informimi përmes medieve, linja telefonike informuese etj. Kjo fazë do të zgjasë deri më 15 mars të këtij viti, kur fillon zbatimi i plotë.

Zbatimi i Ligjit për të Huajt dhe Ligjit për Automjetet synon lehtësimin e qëndrimit të shtetasve jorezidentë në Kosovë.

Po ashtu, kryeministri i informoi ambasadorët e pranishëm mbi domosdoshmërinë e fillimit të integritit gradual të sistemeve të shëndetësisë dhe arsimit, si pjesë e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë. Kryeministri tha se ky proces integruese do të bëhet në koordinim me Bashkimin Evropian dhe duke siguruar që brengat dhe këshillat e komunitetit joshumicë serb në Kosovë merren në konsideratë.

Kryeministri ritheksoi përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për sundimin e ligjit, zbatimin e barabartë të legjislacionit dhe forcimin e rendit juridik, duke u shprehur se periudha në vijim është thelbësore për funksionalizimin e plotë të këtyre proceseve.

PËRRALLAT PËR PRESIDENTIN



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Me muzikë serbe nuk luhet Vallja e Tropojës: Në Kosovë sot mund të mungojë çdo gjë; rryma, uji, barnat, morali, integriteti profesional, respekti dhe përgjegjësia por jo edhe patriotizmi, si strehë e horrave të UDB-së, të sistemuar sot me të gjitha të mirat në partinë anarkiste antishtet dhe antikombëtare të quajtur LV. Sot, 90 për qind të listës së deputetëve të LV-së, ministra të kabinetit qeveritar dhe bartës të posteve institucionale, kurrë në jetën e tyre, personalisht apo familjarisht as edhe një pordhë të vetme nuk e kanë shkrepur për Kosovën e lëre më të kenë bërë ndonjë sakrificë. Ata që dikur kanë bërë atë që çdo patriot e ka detyrim ta bëjë për vendin dhe popullin që i takon, janë palosur para “grazhdit të Albinit” duke harruar dhe mohuar të kaluarën e tyre. Dikur ushtarë krenarë të Adem Jasharit sot rrogëtarë pa dinjitet të grekes Dejana Mihalit. Dikur nxënës dhe studentë të Bacë Adem Demaçit, sot jargavitës të Agim Bahtirit e Haxhi Qamilit! Dikur frymëzoheshin nga Dervish Shaqa dhe Tish Daija, sot nga pevaçicat e Arkanit! Dikur fjala kishte peshë sot rrena dhe mashtrimi janë mbipeshë! Dikur ushqeheshim me patriotizëm nga Fishta dhe “Lahuta e Malcisë”, sot patriotizëm shet Lahutari Laskuc dhe Nezir Kraki me “Shtatë Ligjet e Budallakisë”! Që nga koha e ish-Jugosllavisë, kurrë në Kosovë nuk ka pasur politikanë a qeveri që aq belesh e kanë marrë pushtetin se kjo garnitura kryesisht antikombëtare e LV-së prandaj as që iu intereson se çka bëhet me shtetin deri në kohën sa e kanë pushtetin. Këta, me mendësi jugosllave dhe serbe e që Albin Kurthi i ka metastazuar në të gjitha porët e pushtetit mund edhe të flasin shqip, madje një shqipe të standardizuar të Qabejt dhe Kostallarit sikur që e bëjnë Agim Bahtiri, Matoshi Adriana, Llaloshi Edona, Hajdari Rozeta dhe “gjuhëtarë” tjerë të shquar por 80 për qind e LV-së nuk janë

në gjendje të mendojnë dhe veprojnë shqip sepse nuk e kanë për zemër dhe shpirti nuk ua donë! Sikur edhe një numër i madh i votuesve të tyre, jugonostalgjikë, proserbë, anti UÇK-së, kundër të burgosurve politikën, kundër Bacë Adem Demaçit, kundër Adem Jasharit, kundër Rexhep Malës dhe patriotëve të vërtetë shqiptarë. Për shumicën e tyre, Vallja e Tropojës është kundërvlerë artistike dhe kulturore, Vallja e Uzhicës dhe këngët e Cecës janë identitetet i tyre kombëtar dhe kulturor. Me këto janë rritur, frymëzuar dhe deformuar.

Për Presidentin: Miguel Asturias, shkrimtar dhe diplomat nga Guatemala e ka një roman të shkëlqyer: “Zotëri President” me të cilin, midis tjerash e kishte fituar Çmimin Nobel për Letërsi në vitin 1967 duke përshkruar jetën nën regjimin autokratik dhe diktatorial në Guatemala. Edhe një mandatin 5-vjeçar të Vjosa Osmanit jemi përballur në një autokraci të Kurthit e që “Zonja Presidente” me asgjë nuk e ka penguar, madje ka shërbyer si “Kamxhiku i Atilës” kundër opozitës, medieve, shoqërisë civile, sistemit gjyqësorë në përgjithësi dhe Gjykatës Kushtetuese në veçanti! Në vend ta luftojë autokracinë, i shërbeu si rrogëtarë e bindur! Tash e kërkon edhe një mandat, pa u skuqur fare, e liru dhe çliruar nga çdo skrupull moral. Moti ka pëlçitur marrja! Kurthi tani i adrenalizuar tej mase me 57 deputetë, po e luan të fortin duke luajtur edhe me Vojsën, vështirë t’i bëjë 80 deputetë, e shohim dhe pordhë të tjera. Kurthi është shumë i interesuar ta bëjë Vjosën presidente edhe për një mandat sepse nuk e gjen askënd që i bindet pa asnjë kundërshtim. Kurthi është sadist, nuk e pranon asnjë nënshtrim çfarëdo qoftë ai pa i shkaktuar dhimbje, vuajtje dhe poshtërim të nënshtruarit. Vjosa Osmani i pranon të gjitha këto për edhe një mandat prandaj i paloset Kurthit, ndërsa kërcënon opozitën, personalisht dhe përmes anatomisë të quajtur peci. Kurthi është për Vjosën mirëpo lexova diku se mund ta propozojë Bekim Jasharin për ta kaluar Zajebnicën dhe për t’u mbrojtur nga autoriteti dhe karizma e Hashim Thaçit, nëse ai lirohet. Para se të propozohet Vjosa Osmani, përfolej për Murat Jasharin por se ia hodhën paç sikur kur e propozuan për Avokat të Popullit. Opozita e në veçanti

LDK-ja, në asnjë rrethanë nuk duhet ta votojë Vjosa Osmanin sikurse që nuk e ka asnjë detyrim ta votojë Bekim Jasharin. Opozita duhet ta propozojë presidentin e jo Albin Kurthi. Nëse Albin Kurthi nuk tregohet bashkëpunues, le t’i sigurojë 80 deputetë për zgjedhje të presidentit dhe votim të marrëveshjeve ndërkombëtare. Nëse Kurthi, me zgjedhje të vjedhura dhe të blera me para të shtetit dhe oligarkëve ka për qëllim shtypjen dhe poshtërimin e opozitës, dy duar për një kokë janë! Opozita ose duhet të bëjë punën e opozitës, ose le t’i lëshojë poturet! Opozita nuk ka kohë ta bëjë reformimin e brendshëm sikur në shtetet normale, reformimin duhet t’ia përshtatë rrethanave që nuk është as e rregullt e as normale. Duhet të luftojë me armët e Kurthit. Nuk duhet në asnjë mënyrë të bëhet pjesë e skenarit të fshehtë dhe kriminal për krijimin e Zajebnicës dhe Marrëveshjes së Brukselit dhe Ohrit. Keni parë dvojken Kusari - Pacolli në Solloturn të Zvicrës, bashkë me mjeranat e opozitës. Keni parë dezertorin e UÇK-së, Sfeqlën në Cyrih me paramilitarët politikë të Vuçiqit e këndej kundër Vuçiqit dhe LS-së. Të shoqëruar nga mjeranat e opozitës kosovare. Nëse opozita mendoj të dalë nga koma politike, nuk ka çka kërkon në këto takime. Jam i sigurt se Kurthi do të realizojë të gjitha detyrimet që i ka trashëguar e që janë shumë më të lehta se këto që i ka pranuar bashkë me projugosllavin e përjetshëm, Veton Surroi dhe mercenarin Weller. Kurthi po punon në modelimin e paketimit të federalizimit të Kosovës sikur që e bëri me tokat që ia barti Manastirit të Deçanit, me një nënshkrim brenda natës.

Tash i ka tri kërkesa për normalizim me Serbinë:

1. Tërheqja e letrës së Ana Bernabiqit dërguar vendeve të BE-së.
2. Dorëzimi i Milan Radoiqit, punë që nuk bëhet dhe që asnjë shtet nuk e kërkon. Radoiqi është shtetas i Serbisë dhe Kosova dhe Serbia nuk kanë marrëveshje për ekstradim. Pastaj, Serbia ka filluar procedurën hetimore kundër Radoiqit dhe nuk ka asnjë detyrim ta ekstradojë. Edhe nëse Radoiqi hipotetiki arrestohet në një vend të tretë, ekstradimi, sipas ligjeve ndërkombëtare nuk do të bëhet në Kosovë por në Serbi.

3. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit dhe të Ohrit. Kurthi e ka të qartë që asnjë vend nuk e ka kërkuar që kjo Marrëveshje të nënshkruhet dhe as që do ta kërkojë për faktin që zotimi publik e ka forcën dhe detyrimin e zbatimit të marrëveshjes. Këto “kushte” të Kurthit janë për përdorim të brendshëm për trutharët dhe analfabetët funksionalë të LV-së. Si ai kushti se nuk do të bisedohet me Serbinë pa treguar Serbia se ku janë personat e zhdukur, pa kërkimfalje për krime të luftës në Kosovë dhe pa kompensimin e dëmeve të luftës.
- A e plotësoi Serbia ndonjërin nga kushtet e Kurthit? Asnjërin hiç. A bisedoi Kurthi me Serbinë. Po. Thjesht PO. Kështu do të ndodhë edhe më këto tri kërkesa të Kurthit. Do të bindeni.

Rexhep Malaj dhe Nuhi Berisha: Jemi një grup i shokëve që i kemi ndejtë afër Bacës Adem Demaçi deri sa iku në përjetësi. Sa ishte Baca Adem gjallë bënim bashkë pelegrinazh në Vendpushimet e Përvjetshme të Heronjve të Kombit dhe rregullisht vizitonim familjet e tyre. Tash, neve të gjallëve na ka mbetur detyrim kombëtar dhe moral ta vazhdojmë traditën e Bacës. Kështu vepruam edhe më 11 janar 2026. Elmiu, Avdullahu, Bujari, Fazliu, Selajdini dhe unë vendosëm kurora dhe buqetë me lule në Kompleksin e Dëshmorëve të Kombit në Gjilan dhe në vendprehjet e Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës si dhe në vendprehjen e ish të burgosurit politikë dhe ushtarit të UÇK-së, bashkëveprimtar i ngushtë i Rexhep Malës, Ilmi Ramadani që iku nga kjo botë vitin e kaluar. Mungoi edhe Nuhi Ahmeti që ishte jashtë vendi. Mosha dhe shëndeti i dëmtuar nga burgjet e gjata në llogoret jugosllave po ndikojnë që ne të pakësohemi në numër dhe të kufizohemi në lëvizje. Pastaj e vizituam kazermën e Forcës së Sigurisë në Gjilan. Si çdo herë, vizituam familjen e Rexhep Malës për të bashkëbiseduar dhe këmbyer kujtimet. Nuhi Berishën nuk e kam njohur apo takuar ndonjëherë. Me Rexhep Malën kemi bërë burg bashkë në Foçë dhe Mostar, ish Bosnjë dhe Hercegovina në Jugosllavi. Ishin edhe Skender Kastrati dhe Agim Sylejmani. Rexhep Malaj ishte i jashtëzakonshëm, i lindur për

ilegalitet dhe luftë guerile. I vendosur për sakrificë në çdo kohë dhe për t’i ruajtur shokët në çdo situatë. Në të ngërthehej vizioni politik i Hasan Prishtinës, zemra dhe shpirti luftarak i Çerçiz Topullit si dhe fanari udhërrëfyes drejt lirisë, çlirimit dhe bashkimit kombëtar i Bacë Adem Demaçit. Kishte konstruktin fizik të trashëguar nga shqiptari malësor, Mehmet Malajt, babait të tij që e bëri krenar, si valëzim patriotik i familjes Malaj.

Rexhep Malaj ishte i gatshëm të sakrifikohej në çdo kohë për tri gjëra: lirinë dhe bashkimin kombëtar, për Shqipërinë dhe Bacë Adem Demaçin. Nuk bënte kompromis midis vdekjes së jetueshme dhe sakrificës për liri. Gjithmonë e zgjidhte të dytën, sakrificën për liri. Ne që udhëhiqemi nga kalendarët se sa vite do të jetojmë, se a do të bëhemi prindër të mirë, çfarë gjyshër do të jemi, jemi vdekatarë të rëndomtë, pa vullnet për ta prerë biletën për amshim - përjetësi. Rexhep Malaj nuk ishte i tillë, dallonte nga ne. Rexhep Malaj e kishte një bashkëshorte të jashtëzakonshme dhe madhështore, zonjën Hanife dhe një vajzë që e donte shumë, për mua fotokopje e Rexhepit - Fitoren. Kishte një vëlla shumë të angazhuar politikisht dhe kombëtarisht - Hasan Malën. Një mjedis i mirë për të mbijetuar. Por nuk kishte kushtin kryesor për ta jetuar një jetë të jetueshme - lirinë! Prandaj e zgjodhi rrugën e lirisë, rrugën për të cilën nuk ka çmim që nuk duhet të paguhet. U shndërrua në Yll ndriçues për popujt që e duan lirinë në përgjithësi dhe lirinë shqiptare në veçanti. Rexhep Malaj sot i duhet shumë Kosovës. I duhet fryma e tij, vullneti i tij, gatishmëria për sakrificë dhe mosdorëzimi para asnjë vështirësie. Personalitete si Rexhep Malaj janë shkëndija shekullore, meteorë që gjithmonë lëvizin mbi yllësinë shqiptare. Janë të papërsëritshëm, brenda zjarr të mbështjellë me mbështjellësinë e pavdekësisë! Për aq sa mburremi me Rexhep Malën dhe Heronjtë e Kombit, ndjehemi me faj që rrugën e tyre nuk e përfunduam. Disa thjesht u lodhën, disa u dhanë pas pasurisë, disa i shitën për karrige, disa pas grykësisë. Prandaj Rexhep Malaj, na fal dhe mëshirohu ndaj nesh. Thjesht nuk ishim si ti, në pamje po, në veprime jo.

Policia me aksion në veri kundër lojërave të fatit

PRISHTINË, 16 JANAR - Policia e Kosovës ka kryer aksion në Zubin Potok, duke bastisur tri lokale ku dyshohet se janë organizuar skema piramidale dhe të bixhozit. “Në të tri lokacionet janë hasur pajisje teknologjike të cilat mundësojnë zhvillimin e lojërave të fatit si dhe janë pesë të dyshuar, ku tre prej tyre janë duke u intervistuar, kurse dy të tjerë nuk janë hasur aty, por janë

të njohur për Policinë, ndërsa janë intervistuar edhe pesë dëshmitarë”, tha për Radion Evropa e Lirë, Veton Elshani, zëvendës drejtor i Policisë për Veriun. Zubin Potoku, ku u krye aksioni, është një nga katër komunat në veri të Kosovës, ku shumica e popullatës janë serbë. Nga Policia, po ashtu, njoftuan se prokurori kujdestar ka udhëzuar të iniciohen tri raste

për veprën penale të “Organizimit të skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”. Sipas nenit 294 të Kodit Penal të Kosovës, kushdo që me qëllim të pasurimit për vete apo të një personi tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e skemave piramidale mund të dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Dënim nga dy deri në dymbëdhjetë vjet burgim parashihet në rastet kur përmes lojërave të fatit një person ka fitim ose humb një shumë prej 25 mijë eurosh. Në Kosovë, përmes një ligji të miratuar më 2019, u ndaluan dhe u mbyllën të gjitha lokalet që organizonin lojëra të fatit. Kjo ndalesë u ndërmor nga Qeveria e atëhershme e Kosovës pas disa vrasjeve që ndodhën nëpër



kazino dhe po atë vit u mbyllën rreth 400 lokale dhe shumica nga to merreshin me baste sportive. Më 2024 Radio Evropa e Lirë ka raportuar se, megjithatë, bastet kanë vazhduar të organizohen online.

KE-ja PRET HEQJEN E PLOTË TË MASAVE NDAJ KOSOVËS NË JAVËT E ARDHSHME

PRISHTINË, 16 JANAR - Komisioni Evropian (KE) ka konfirmuar se pret heqjen e plotë të masave ndaj Kosovës në javët e ardhshme. Jan Gert Koopman, drejtor i Drejtorisë për Zgjerim në KE, theksoi se bëhet fjalë për lirim të më shumë se 400 milionë eurove, përfshirë edhe masat që KE-ja i kishte hequr fillimisht në dhjetor të vitit të kaluar. Ai ka shpjeguar se institucionet po punojnë paralelisht në programimin e mjeteve dhe në kontraktimin e projekteve që do të financohen. “Midis programimit dhe kontraktimit, në praktikë do të hiqim të



gjitha masat financiare në javët e ardhshme, dhe kjo është pikërisht ajo që ka deklaruar kryetarja jonë dhe çfarë po

bëjmë aktualisht”, ka deklaruar Koopman para Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë të Parlamentit Evropian.

Bashkimi Evropian (BE) vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës më 2023, pa ndjekur procedurat përkatëse që kërkojnë për një vendim të tillë. Masat kishin të bënin me pezullim të financimit dhe të takimeve dypalëshe midis zyrtarëve evropianë dhe përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës. Masat u vendosën si përgjigje për shkak të tensioneve në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, pasi kryetarët shqiptarë të katër komunave në veri morën mandatin. Atëbotë pati edhe përplasje mes protestuesve serbë me forcat e sigurisë, përfshirë me

pjesëtarët e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. Teksa po hiqen masat ekonomike, ende nuk ka një shpjegim zyrtar se si do të veprohet sa iu përket masave politike, pra takimeve të zyrtarëve të BE-së me ata të ekzekutivit të Kosovës. Zyrtarët evropianë theksojnë se ka marrëveshje edhe për këtë çështje dhe se ajo do të zbatohet “spontanisht” menjëherë pas konstitutimit të Kuvendit të ri të Kosovës dhe formimit të qeverisë së re të dalë nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit.

FORMOHET KËSHILLI I EKSPERTËVE PËR PROGRAME DHE TEKSTE SHKOLLORE

Qendresa RAMA
PRISHTINË, 16 JANAR - Me qëllim të avancimit të cilësisë së arsimit dhe forcimit të bazës profesionale në zhvillimin e programeve mësimore dhe teksteve shkollore, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka formuar Këshillin e Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore (KEPTSh). Ky këshill përbëhet nga ekspertë të fushës së arsimit, të cilët do të kontribuojnë në analizimin dhe vlerësimin e programeve mësimore, shqyrtimin profesional të teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore, si dhe në



dhënie të rekomandimeve në përputhje me Kornizën Kurrikulare të Kosovës dhe

standardet bashkëkohore të arsimit. Përbërja e Këshillit: Anita

Kadriu kryesuese, Fatos Osmani anëtar, Zana Zeqiri anëtare, Nazan Safqi anëtare, Merita Gashi anëtare, Driana Sogojeva anëtare, Arbnor Pozhegu anëtar, Agim Bujari anëtar, Laura Lipoveci anëtare, Flamur Maloku anëtar, Linda Ukimeraj Harris anëtare dhe Leunorë Krasniqi sekretare e Këshillit. Ministrja në detyrë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, priti në takim anëtarët e rinj të KEPTSh-it. Gjatë këtij takimi u diskutuan pikat kyçe të aktiviteteve dhe punëve të parapara në planin dinamik të Këshillit, me fokus të veçantë në: procesin e rishikimit të programeve mësimore; shqyrtimin e dokumentacionit pedagogjik; rishikimin e listës së lekturave shkollore dhe pasurimin e saj me tituj të rinj; hartimin dhe përzgjedhjen e teksteve për komunitetet joshumicë; përgatitjen e Katalogut të teksteve shkollore, si dhe çështje të tjera me rëndësi për sistemin arsimor. Formimi dhe funksionalizimi i këtij këshilli përbën një hap të rëndësishëm drejt sigurimit të cilësisë, koherencës profesionale dhe modernizimit të përmbajtjeve mësimore në arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Hamza vlerëson kontributin e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në forcimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve

PRISHTINË, 16 JANAR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka zhvilluar të premten një takim me shefen e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Kosovë, Heleni Vakali, ku u diskutuan zhvillimet e fundit politike në vend, marrëdhëniet

dypalëshe dhe proceset me interes të ndërsjellë. Hamza shprehu mirënjohjen për rolin konstruktiv të Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Kosovë, duke vlerësuar kontributin e saj në forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve.

Duke folur për zhvillimet politike, Hamza ritheksoi se PDK-ja mbetet e përkushtuar për ruajtjen e stabilitetit politik, promovimin e dialogut konstruktiv dhe avancimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës.



KOSOVA NË PRITJE TË BUXHETIT, EKSPERTËT PARALAJMËROJNË KOLAPS

PRISHTINË, 16 JANAR - Njohës të rrethanave politike dhe ekspertë ekonomikë kanë paralajmëruar për pasoja serioze nëse bllokada politike rreth miratimit të buxhetit vazhdon edhe gjatë vitit 2026. Nëse vendi hyn në fund të muajit shkurt pa buxhet të miratuar, Kosova rrezikon të përballet me kolaps ekonomik dhe social. Politologu Artan Muhaxhiri kujton se kriza e vitit të kaluar nuk guxon të përsëritet. Sipas tij, “bllokada e vitit të kaluar i ka kaluar të gjitha limitet dhe nuk duhet të lejohet të ndodhë sërish”. Muhaxhiri thekson se buxheti është çështje jetike për funksionimin e shtetit, ndërsa rrezikimi i institucioneve përmes kalkulimeve politike është një skenar që, sipas tij, as që



duhet të merret parasysh nga politikanët. “Çështja e buxhetit është jetike për shtetin e Kosovës. Do të ishte absolutisht e papërgjegjshme nga politikanët tanë dhe nga partitë tona që të bënin të njëjtën lojë me vonesa të

pafundme dhe ta rrezikonin edhe më tej funksionimin e institucioneve. Ky është një skenar që as që duhet të merret parasysh, nëse kanë qoftë edhe një pikë normaliteti”, ka thënë ai për “Radio Kosovën”.

Kritika ndaj situatës ka shprehur edhe ekonomisti Safet Gërxhaliu, i cili ka thënë se problemet e vitit 2025 tashmë po barten në vitin 2026, duke krijuar ndikime negative në disa drejtime. Ai ka paralajmëruar se mungesa e buxhetit të miratuar dhe vakuumi institucional po e dobësojnë performancën e shtetit, ndërsa projektet kapitale të planifikuara për vitin 2026 kanë mbetur në pritje. Sipas tij, kjo vonesë ka një kosto të drejtpërdrejtë, sidomos në kohë inflacioni. Gërxhaliu thekson se buxheti duhet të jetë prioritet absolut i klasës politike. “Ajo që është më e rëndësishme është se buxheti duhet të jetë prioritet, sepse nuk jetohe vetëm me bartje buxhetore, me 1/12 e vitit paraprak. Politikanët kosovarë duhet të

ngrihen mbi interesat për pushtet dhe sa më shpejt që të ndodhë kjo, aq më shpejt do të ketë kthim të shpresës se gjërat në Kosovë do të normalizohen. Përndryshe, nëse vazhdohe me këtë maratonë zgjedhjesh dhe na zë fundi i shkurtit pa miratimin e buxhetit, atëherë fillon kaosi financiar dhe do të jetë shumë e vështirë të dilet nga një situatë e tillë. Prandaj, është koha që këto sfida të evitohen dhe të zgjidhen, e jo të shërohen, sepse nëse nuk kemi institucione funksionale dhe kemi kalkulime për poste politike, përfshirë atë të presidentit apo presidentes, e nuk miratohet buxheti, Kosovën e pret një kolaps që do ta dëmtojë rëndë vendin si në aspektin ekonomik, po ashtu edhe në atë social”, ka thënë Gërxhaliu.

259 MILIONË EURO IMPORTI I RRYMËS NË VITIN 2025, YMERY NGRE DYSHIME PËR NOA-n DHE VUK HAMOVIQIN

PRISHTINË, 16 JANAR - Deputetja e zgjedhur e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Janina Ymeri, ka ngritur dyshime të drejtpërdrejta për përfitime tregtare nga importi i energjisë elektrike, duke përmendur kompani konkrete dhe shifra financiare. Në “Përballje Podcast” në Telegraf, Ymeri tha se importuesja më e madhe e energjisë elektrike në Kosovë është kompania NOA. “Kush po përfiton? NOA sepse është importuesja më e madhe e energjisë elektrike....”, ka deklaruar Ymeri. Ajo ka theksuar se importi nuk duhet të ngatërrohet gjithmonë me bartjen e energjisë, duke sqaruar se ky është një proces më kompleks. “Po jo edhe bartësi gjithmonë. Edhe bartja ka shumë rëndësi në energji elektrike. Nuk është si taksitë që presin gjithë kohën me ta bartë një person ose një valixhe”, u shpreh ajo. Ymeri ka sqaruar se vlera e importit të energjisë ka arritur në 259 milionë euro, duke



precizuar se bëhet fjalë për vitin 2025. “Dyqind e pesëdhjetë e nëntë milionë euro vitin e kaluar”, ka pohuar ajo gjatë diskutimit. Sipas Ymerit, pjesa më e madhe e këtyre mjeteve ka shkuar pikërisht te importuesi më i madh. “Këto që i kemi të dhëna janë të NOA-s, që ka

qenë importuesja më e madhe”, ka deklaruar ajo. Duke folur për bartjen e energjisë, Ymeri tha se në ankandet ditore dhe mujore ka dominuar Vuk Hamoviq përmes kompanive të lidhura në rajon. “Në bartje ka dominuar në ankandet ditore

dhe mujore Vuk Hamoviqi, me kompani nga Mali i Zi dhe Maqedonia, sepse kur hyn për bartje, hyn me tri biznese”, ka theksuar Ymeri. Ajo shtoi se, sipas dyshimeve të ngritura në një raport të KOSTT-it, ka pasur edhe bashkëpunime të tjera që

kërkojnë sqarim institucional. “Ka qenë edhe ‘Elektroprivreda’ që tash po del se ka bashkëpunuar me NOA-n, sipas dyshimeve dhe sipas një raporti të KOSTT-it. Ata e dinë më së miri çka ka ndodhur dhe janë më të duhurit për të treguar”, ka thënë Ymeri.

Hyn në fuqi vendimi i qeverisë për pagën minimale, nga janari 425 euro, 500 euro në korrik

PRISHTINË, 16 JANAR - Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimin për rritjen e pagës minimale, duke përcaktuar dy faza të reja të rritjes gjatë vitit 2026. Sipas vendimit zyrtar me numër 10/273, të datës 31 tetor 2025, i nënshkruar nga

kryeministri në detyrë Albin Kurti, paga minimale do të jetë: 425 euro bruto duke filluar nga 1 janari 2026, për një punë të rregullt me orar të plotë dhe 500 euro bruto duke filluar nga 1 korriku 2026, po ashtu për punë të rregullt me orar të plotë. Me këtë vendim:

Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Inspektorati i Punës për zbatimin e tij. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



303 MILIARDË FUÇITË QË NDRYSHOJNË EKUILIBRAT BOTËRORË

Rezervat më të mëdha të naftës në botë mes kostove të larta të nxjerrjes, rënies së prodhimit dhe tensioneve të reja gjeopolitike



E shtuna e parë e vitit 2026 do të mbetet e gdhendur në kujtesën gjeopolitike të Amerikës Latine si dita kur Shtetet e Bashkuara vendosën të kapërcenin çdo barrierë kujdesi dhe të ndërhynin ushtarakisht në Venezuelë për të kapur presidentin Nicolás Maduro. Një zgjedhje pa precedent, që e shndërroi një konflikt të zgjatur në një krizë të hapur, me pasojat të thella për sovranitetin shtetëror, rendin ndërkombëtar dhe tregun global të energjisë.

Ari i zi i Karakasit

Megjithatë, kjo lëvizje nuk ishte thjesht një akt “policor”: Shtetet e Bashkuara nuk u kufizuan në kapjen e një kreu shteti të akuzuar për krime transnacionale, por shpallën hapur se synojnë të marrin një rol drejtues në Venezuelë, deri sa të garantohet një “tranzicion i rregullt” i pushtetit. Presidenti amerikan deklaroi se angazhimi i SHBA-së nuk do të ndalet te operacioni i kapjes, por do të vazhdojë me menaxhimin e vendit, me objektivin e shpallur për të stabilizuar situatën e

brendshme dhe për të ringritur ekonominë kombëtare. Edhe pse i gjithë operacioni i ngjan më shumë një rinegociimi të ashpër të sferave të influencës pas Luftës së Ftohtë, sesa një luftë energjetike në kuptimin e drejtpërdrejtë, elementi kyç i kësaj narrative mbetet nafta. Venezuela zotëron një nga rezervat më të mëdha të naftës në botë, me vlerësime të besueshme që flasin për rreth 303 miliardë fuçi si rezerva të provuara. Kjo sasi tejkalon atë të çdo vendi tjetër dhe përfaqëson pothuajse një të pestën e rezervave globale. Megjithatë, vlera teorike e kësaj pasurie ka qenë historikisht e vështirë për t’u shndërruar në të ardhura reale ekonomike. Pavarësisht këtij potenciali, prodhimi i brendshëm, që në të kaluarën e afërt kishte arritur nivele shumë më të larta, është reduktuar ndjeshëm.

Një sektor i goditur nga brishtësi sistemike

Në vitet ’90 dhe në fillim të viteve 2000, Venezuela prodhonte mbi tre milionë fuçi naftë në ditë,

duke u renditur ndër prodhuesit më të mëdhenj globalë. Sot, pas dekadash keqmenaxhimi, korrupsioni sistematik dhe sanksionesh ndërkombëtare, prodhimi ka rënë në një pjesë të vogël të atyre shifrave. Në vitin 2024, prodhimi mesatar kombëtar luhatej rreth 950.000 fuçi në ditë, dhe disa muaj eksportet arritën rreth 900.000 fuçi në ditë, sinjale të një rimëkëmbjeje të kujdesshme, por shumë larg niveleve historike të kapacitetit të plotë. Në vitin 2025, të dhënat zyrtare tregojnë një prodhim rreth 1,1 milion fuçi në ditë, një shifër që sinjalizon një rikuperim të lehtë krahasuar me vitet më të errëta të krizës së naftës, por që mbetet modeste nëse krahasohet me potencialin teorik që burojnë nga rezervat gigante të disponueshme.

Problemet e “naftës ekstra të rëndë”


Nafta venezueliane është kryesisht “naftë ekstra e rëndë”, një lloj burimi energjetik më i vështirë dhe ekonomikisht më i kushtueshëm për t’u nxjerrë

dhe përpunuar krahasuar me nafta e lehta. Kjo shpjegon pse, pavarësisht pasurive të mëdha, vendi arrin të prodhojë kaq pak: nafta ekstra e rëndë është shumë e dendur dhe viskoze, prandaj e vështirë për t’u nxjerrë. Shpesh duhet të ngrohet nën tokë ose të hollohet me nafta të tjera. Ajo përmban gjithashtu më shumë sqfur dhe metale, duke e bërë përpunimin dhe rafinimin më kompleks dhe më të shtrenjtë. Mund të përpunohet vetëm në rafineri shumë të specializuara, gjë që kufizon blerësit dhe ul marzhet e fitimit. Me pak fjalë, kërkon më shumë energji, më shumë teknologji dhe më shumë investime në të gjithë zinxhirin e prodhimit.

Projektet e Uashingtonit

Vitet e investimeve të mangëta dhe kriza e PDVSA-së, kompanisë shtetërore të naftës që dikur ishte shtylla kurrizore e ekonomisë kombëtare, e kanë bërë aparatën prodhuese të brishtë dhe të vjetëruar. Presidenti amerikan ka theksuar

se kompanitë energjetike amerikane mund të sjellin kapital dhe njohuri teknike për të rindërtuar sektorin, duke parashikuar investime mbi 100 miliardë dollarë dhe duke nënvizuar se do të nevojiten vite, në mos dekada, punë e vazhdueshme për ta rikthyer prodhimin drejt niveleve para krizës. DimENSIONI energjetik i Venezuelës është dhe do të mbetet qendror jo vetëm për Karakasin dhe Uashingtonin, por për të gjithë tregun botëror të energjisë. Në një kontekst ku OPEC+, karteli ku Venezuela ishte ndër anëtarët themelues, ka vendosur të mbajë të qëndrueshme nivelet e prodhimit për të shmangur tronditje të tjera, gjendja e vendit të Amerikës së Jugut mbetet një faktor pasigurie. Aftësia e saj për të ndikuar në çmimin ndërkombëtar të naftës mbetet potencialisht e rëndësishme, edhe pse prodhimi aktual është i pamjaftueshëm për të ushtruar një ndikim të ndjeshëm në afat të shkurtër. / bota.al



Drita mëson kundërshtarin e plejofit të fazës nokaut

NYON, 16 JANAR - Drita e ka mësuar të premtën kundërshtarin e plejofit të fazës nokaut të Ligës së Konferencës, në shortin e tërhequr në Nyon të Zvicrës. Drita do të përballlet me Celjen sllovene. Drita e ka përfunduar

fazën e ligës në Ligën e Konferencës në pozitën e 20 me tetë pikë. Ishte sukses historik, ndërsa kjo është arritur në debutimin e skuadrës gjilanasë. Kampionia e Kosovës do të jetë vendëse në ndeshjen e parë që luhet më 19

shkurt në stadiumin "Fadil Vokrri", ndërsa kthyesë do të luhet në udhëtim më 26 shkurt. Në rast të kalimit të Celjes sllovene, Drita e Gjilanit do të luajë kundër Spartës së Pragës apo AEK-ut të Athinës, në 1/8 e finales së Ligës së

Konferencës. Kampionia e Kosovës do të jetë vendëse edhe në ndeshjen e parë të asaj faze të garës në rast të avancimit tutje. Te Sparta e Pragës luan Albion Rrahmani. Rrahmani ka luajtur disa herë kundër Dritës, sa ishte



futbollist i Ballkanit në elitën e futbollit të Kosovës.

KUKA: TË NDËRTOSH KAMPIONË NGA KOSOVA ËSHTË SI TA NDËRTOSH NJË 'FERRARI'

PRISHTINË, 16 JANAR - Trajneri i Kombëtares së Kosovës në xhudo, Driton "Toni" Kuka, i njohur për sukseset e tij ndërkombëtare, ka ndarë vizionin dhe filozofinë e tij të punës në fillim të ciklit kualifikues për Lojërat Olimpike Los Angeles 2028. Kuka, udhëheqësi i ekipit që ka sjellë për Kosovën pesë medalje olimpike, përfshirë tri të arta, ka thënë se puna me sportistë të shkallës botërore nga një vend i vogël kërkon një "Ferrari", makinë e ndërtuar me kujdes të jashtëzakonshëm. Në një intervistë për faqen zyrtare të Federatës Evropiane



të Xhudos (EJU) gjatë kampit stërvitor olimpiq në Mittersill, trajneri Kuka ka shpjeguar se

me burime të kufizuara duhet të krijohen kampionë që mund t'i rivalizojnë fuqitë botërore.

Ai ka thënë se ekipi synon 3 deri 5 kualifikime olimpike për LA2028, duke përmendur emrat e sportistëve kryesorë si Distria Krasniqi, Laura Fazliu dhe Akil Gjakova, si dhe brezin e ri që po zhvillohet. Në pjesën e parë të një serie me tri pjesë, trajneri i kombëtares së Kosovës, Driton Kuka, i njohur me dashuri si "Toni", ka folur hapur për filozofinë e tij unike të trajnimit, sakrificat që qëndrojnë pas medaljeve të arta olimpike dhe arsyen pse ndërtimi i kampioneve nga një vend i vogël kërkon krijimin e një "Ferrari" nga e para. "Ne, si Kosovë, me një bazë të vogël

dhe me një numër të kufizuar sportistësh, duhet që nga një sportist të ndërtojmë një "Ferrari", ka thënë Toni, deklarati kjo që prek thelbin e filozofisë së tij. "Prandaj është shumë e vështirë të kombinohet jeta normale me jetën e një sportisti të nivelit të lartë", ka thënë Kuka. Kjo metaforë, ndërtimi i një "Ferrari", përmbledh gjithçka rreth qasjes së Kukës. Ajo është e përpiktë, kërkuese dhe pa kompromise. Megjithatë, është edhe e vetmja mënyrë që një vend me më pak se dy milionë banorë ka arritur të qëndrojë krah për krah me superfuqitë e xhudos në podiumin olimpiq.

PAS REZULTATEVE ZHGËNJYESE, MURIQI KËRKON MBËSHTETJE NGA TIPOZËT E MALLORCAS

MAJORCA, 16 JANAR - Mallorca po kalon një nga periudhat më të vështira të sezonit, pas dy paraqitjeve zhgënjyese ndaj Gironës dhe Rayo Vallecanos, që e kanë afruar skuadrën pranë zonës së rënies nga kategoria. Situata u tensionua edhe më shumë të dielën, pas reagimeve të tifozëve në stadium. Në këtë kontekst, sulmuesi nga Kosova, Vedat Muriqi, ka folur për radion "COPE", duke u bërë thirrje tifozëve për bashkim dhe mbështetje në këtë fazë vendimtare të sezonit. "Nëse i prishim lidhjet me tifozët edhe 19 ndeshje për t'u luajtur, atëherë kemi mbaruar", është

shprehur Muriqi, duke theksuar se e kupton frustrimin e tifozëve, por është i bindur se situata mund të ndryshojë. Pavarësisht se ka realizuar 11 gola në gjysmën e parë të sezonit, një rekord personal, Mallorca nuk ka arritur ta përmirësojë renditjen. Megjithatë, Muriqi beson në një gjysmë të dytë shumë më pozitive dhe ka kujtuar mbështetjen vendimtare të tifozëve në sezonet e kaluara, sidomos gjatë mbijetesës dramatike nën drejtimin e Javier Aguirres. Sulmuesi 30-vjeçar ka minimizuar edhe incidentet me tifozët, duke theksuar se bisedat kanë qenë

kryesisht të qeta dhe konstruktive. Ai ka pranuar se skuadra po vuan nga mungesa e besimit dhe krijon pak raste, por garantoi se lojtarët janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë. "Askush në skuadër nuk dëshiron të humbasë. Është detyra jonë ta ndryshojmë situatën", ka thënë ai. Muriqi është shprehur i pakënaqur edhe me disa vendime të arbitrave, veçanërisht për faullet në duelet ajrore, ndërsa për rolin e liderit theksoi se nuk ka nevojë për shiritin e kapitenit për ta udhëhequr skuadrën. Mallorca gjendet në pozitën e 17 në tabelën e La Ligas pas 19 ndeshjeve të luajtura.



KB Rahoveci 029 ndërpret bashkëpunimin me trajnerin Bujar Loci

RAHOVEC, 16 JANAR - Klubi i Basketbollit (KB) Rahoveci 029 ka njoftuar zyrtarisht se, me marrëveshje të dyanshme, ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Bujar Loci. Trajneri Loci ishte pjesë e klubit për një

sezon e gjysmë, periudhë gjatë së cilës ka dhënë kontribut të rëndësishëm në inkuadrimin dhe zhvillimin e skuadrës. Me përkushtim, profesionalizëm dhe punë të palodhshme ai ka lënë gjurmë

pozitive në rrugëtimin e klubit, duke ndihmuar në ndërtimin dhe konsolidimin e ekipit. KB Rahoveci 029 ka falënderuar trajnerin Bujar Loci për angazhimin dhe korrektësinë e treguar gjatë

gjithë bashkëpunimit, duke i uruar suksese dhe mbarësi në vazhdim të karrierës së tij profesionale. "Faleminderit për gjithçka, Buki!", është thënë në njoftimin e KB Rahoveci 029.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Auto Sallon Te Arbeni" SH.P.K. pronar Ferki Sokoli me seli në Vushtri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811421677 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Auto Sallon Te Arbeni" D.O.O. Ferki Sokoli Vugitem donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811421677 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Auto Sallon Te Arbeni" L.L.C. with owner Ferki Sokoli with headquarters Vushtri, has come to the decision to quit its business: 811421677 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besmir Elezi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “22 Dëshmorët” në Randogravë Prizren.

- Luan Krasniqi shpall te pavlefshme
dëftesat e kl I - IX shfmu " Fadil
Hisari" Prizren

- Bekim Berisha nga Rogova, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U. "Haxhi Hoti", Rogovë, Gjakovë.

- Enver Muqaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11Marsi" Prizren.

- Fatbardhe Batusha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F. "Jahë Salihu", Molliq, Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Nobel Ajroni B.I, nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin identifikues të biznesit me numër: 811279183, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Jeton Hyseni B.I. shpall të pavlefshme arkën fiskale me nr. DG06603458 me nrb. 811111856.


-Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Zoja Lleshaj shpall të pavlefshme
dëftesën e plotë të shkollës sh.f.m.u.
"Dëshmorët Leshi" Doblibare nga kl.
1-8.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Tsunami SH.P.K. shpall të pavlefshme numrin identifikues të biznesit me nr. 81220031 të lëshuar nga ARBK.

- Festim Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Fadil Hisari" Prizren.



Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

Abirapa Teatrıt, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

